



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2020:022004

Datë: 25.09.2023

Numri i dokumentit: 04715008

C.nr.714/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Freskim Musliu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.S.nga Prishtina, kundër të paditurit S.K.nga Obiliqi., me objekt kontesti kthim borxhi, pas mbajtjes të seancës përgatitore të datës 21.09.2023, me datë 25.09.2023 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

në bazë të pohimit

APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësit R.S. nga Prishtina dhe DETYROHET i padituri S.K. nga Obiliqi që paditësit në emër të kompensimit të borxhit t'ia paguajë shumën prej 300.00 (treqind) euro, në afat prej 7 ditësh nga marrja e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësi, ka dorëzuar padi në këtë gjykatë me datë 13.02.2020, në të cilën ka deklaruar se këtu i padituri S.K.ka qenë palë paditëse në një kontest pune me Komunën e Obiliqit, në të cilin kontest është përfaqësuar nga paditësi avokat R.S.nga Prishtina, ku ky kontest është zgjidhur në favor të palës që ka përfaqësuar, prej nga këtu i padituri ka realizuar shumën prej 1,185.00 €.

Ka shtuar se si rezultat i këtij përfaqësimi dhe suksesit në kontestin me komunën e Obiliqit, të paditurit i është krijuar borgji, i cili kërkohet në kërkesëpadi dhe atë 104.00 € për padi dhe 135.00 € një përfaqësim, të cilat gjithsej rezultojnë 240.00 €, si dhe 10 % nga shuma e realizuar nga i padituri, që gjithsej këto janë 342.00 €.

Paditësi, në seancën përgatitore me 21.09.2023, ka bërë zvogëlimin e kërkesës monetare ndaj të paditurit, asisoj që për padi ka kërkuar shumën prej 104 euro, për përfaqësim ka kërkuar 101 euro, ndërsa për 10% të shumës së realizuar nga i padituri shumën prej 100 euro, që i bie 310 euro, por që në total nga gjykata ka kërkuar t'i aprovohet shuma prej 300.00€ dhe atë pa kamatë ligjore, me afat pagese 7 ditë nga marrja e aktgjykimit.

I padituri në këtë seancë përgatitore të mbajtur me 21.09.2023 e ka pohuar në tërësi kërkesëpadijnë e paditësit të zvogëluar në seancë, dhe ka kërkuar nxjerrjen e aktgjykimit në bazë të pohimit, duke premtuar se këtë shumë do ta paguajë menjëherë me pranimin e vendimit.

Gjykata, pas pohimit të kërkesëpadisë nga ana e të paditurit, konstatoi se kërkesa është e natyrës së disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 148, paragrafit 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se “*në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimin në bazë të pohimit)*”, vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA FUSHË KOSOVË  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
C.nr.714/20, datë 25.09.2023

Gjyqtari

---

Freskim Musliu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181, par. 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.